



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije



Nr. Prot. 030/B/12

RREGULLORE

PËR

**DREJTËN E SHTEGUT DHE SHFRYTËZIMIN E PËRBASHKËT TË
INFRASTRUKTURËS**

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Baza Ligjore

- (1) Kjo Rregullore është nxjerr në bazë të nenit 1, pikat (1) dhe (2), nenit 27, dhe nenit 67 të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-085 (tutje referuar si - Ligji); pikave (3.6.2) dhe (3.6.3) të dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të datës 13/06/2007; Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE); Neneve 11 dhe 12 të Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), të ndryshuar me Direktivën Nr. 2009/140/EC, të datës 25/11/2009.

Neni 2

Qëllimi dhe Fushëveprimi

- (1) Qëllimi i kësaj Rregullore (tutje referuar si - Rregullorja) është inkurajimi i shfrytëzimit efikas të infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturës tjetër të përshtatshme për shtrirjen dhe/ose akomodimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike (tutje referuar si - infrastruktura) me qëllim të zvogëlimit të koston për shtrirje të rrjetave publike të komunikimeve elektronike (tutje referuar si - rrjeti i komunikimeve elektronike);
- (2) E drejta për të shfrytëzuar infrastrukturën në nivel nacional dhe komunal do të ju ofroj operatorëve mundësinë e shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtë se sa në rastet kur infrastruktura nuk do të përdorej aty ku do të kishte mundësi;
- (3) Me qëllim që operatorëve në Republikën e Kosovës t'u ofrohen benefitet e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Rregullorja përcakton kërkesat për të drejtën për shteg, procedurat dhe kushtet, sipas të cilave operatorët mund të përdorin infrastrukturën;

- (4) Rregullorja zbatohet ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, duke përfshirë edhe ata publik, si dhe pronarëve/kontrolluesve të infrastrukturës.

Neni 3 Definicionet

- (1) Për qëllim të kësaj rregulloreje;
- (1.1) Kuptimi ose definicioni i cilëndo fjalë, frazë apo shprehje në bazë të Ligjit, do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore,
- (1.2) Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë këtë kuptim;
- a) **E Drejta për Shteg:** paraprakisht e dhënë (pre-given) operatoreve me të drejtë të shfrytëzimit të infrastrukturës për qëllime të shtrirjes, ri-konstruktimit, mbrojtjes, mirëmbajtjes, bashkë-shfrytëzimit, zhvendosjes (tutje referuar si - shtrirje) të rrjetit të komunikimeve elektronike;
 - b) **Infrastruktura e komunikimeve elektronike:** infrastruktura fizike, e përbërë prej pajisjeve harduerike, përfshirë antenat, linjat, tubat, kabllo, kanalet, përcuesit, pusetat dhe kabinetet/dollapët, shtyllat, dhe konstruksionet tjera mbështetëse, ndërtesat ose hyrjet në ndërtesa, shpërndarjen e kabllove në ndërtesa dhe pajisjeve tjera, të dedikuara për ofrim të aktiviteteve të komunikimeve elektronike;
 - c) **Operatorët:** nënkupton një ndërmarrje/entitet ligjor i cili ofron ose është i autorizuar për të ofruar rrjete të komunikimeve elektronike ose pajisjeve shoqëruese;

KAPITULLI II Kërkesat për të Drejtën për Shteg

Neni 4 Parimet bazë për shtrirjen e Infrastrukturës së komunikimeve elektronike

- (1) Operatori do të ketë të drejtë që të shtrijë rrjetin e komunikimeve elektronike në tokën në pronësi të tij, në bazë të së drejtës mbi pronësinë ose në bazë të së drejtës së servitutit, apo kur operatori ka të drejtë ta përdorë atë në baza të tjera pa ndryshuar qëllimin e tokës;
- (2) Zhvendosja (re-location) e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, e bërë me rastin e ndërtimit ose rikonstruktimit të ndërtesave, urave dhe strukturave tjera, do të kryhet nga personat, të cilët kanë urdhëruar punimet e tilla për ndërtim/rikonstruktim në llogari të tyre sipas specifikimeve teknike të ofruara nga pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe pas koordinimit të punës për zhvendosje me pronarët e lartpërmendur, përpos nëse personat që kanë urdhëruar punime të tilla për ndërtim/rikonstruktim dhe pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike nuk janë marrë vesh ndryshe;
- (3) Personi që ka urdhëruar shtrirjen e infrastrukturës, para se punimet e tilla të fillojnë, në përputhje me procedurën, kushtet dhe rastet e përcaktuara në aktet ligjore për instalimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, do të bëjnë publike informacionin në lidhje me fillimin e punimeve të shtrirjes dhe për mundësinë që personat tjerë të marrin pjesë bashkërisht në shtrirjen e përbashkët të rrjetit të komunikimeve elektronike.

Neni 5

Shtrirja e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në sistemet rrugore

- (1) Pasi të kenë koordinuar veprimet e tyre me institucionet shtetërore ose komunale, personat mund të përdorin hapësirat si: koristë e rrugëve nacionale dhe atyre komunale, rrugët hekurudhore, shtyllat dhe tubat për bartjen e elektricitetit, sistemet e nxehjes dhe kanalizimit, sheshet, tubacionet, resurset ujore dhe brigjet e tyre, urat, viaduktet, tunelet dhe strukturat tjera për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- (2) Me përfundimin e shtrirjes së rrjetit të komunikimeve elektronike, personi që ka urdhëruar një gjë të tillë duhet t'i rregulloj rrugët dhe/ose strukturat përkatëse, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga aktet ligjore;
- (3) Asnjë operator publik i rrjeteve të komunikimeve elektronike nuk mund të hyj në marrëveshje me ndonjë pronar të infrastrukturës sipas paragrafit (1) të këtij neni, e cila do të shpinte në të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të infrastrukturës në fjalë, kur janë në pyetje qëllimet e komunikimeve elektronike.

Neni 6

E drejta e servitutit për shtrirjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike

- (1) Kur një operator nuk mund ta realizoj të drejtën për të shtrirë rrjetin e komunikimeve elektronike, as sipas rasteve si në vijim:
 - a) Shtrirjes së përbashkët;
 - b) ndarjes së Infrastrukturës;
 - c) as me ndonjë mënyrë tjetër,
 - d) e gjithashtu në rastin e dështimit të negociatave me pronarët e pronave, të cilat mund të përdoren për shtrirjen e Infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike,

ky operator mund t'i drejtohet gjykatës për dhënien e së drejtës, kur një mundësi e tillë ekziston dhe kur kjo nuk paraqet një barrierë të panevojshme për pronarin, që ta përdor pronën shtetërore, komunale ose private për shtrirjen e infrastrukturës duke krijuar te drejtën e servitutit në këtë pronë.

KAPITULLI III

Shfrytëzimi i përbashkët i Infrastrukturës

Neni 7

Kërkesat e përgjithshme

- (1) Pronari i një infrastrukture obligohet të lejoj përdorimin e kësaj infrastrukture, në rastet kur ka të bëjë me mbrojtjen e interesit kombëtar dhe sigurisë, të rendin publik si dhe në rastet tjera emergjente;
- (2) Nëse operatorin nuk mund të realizoj të drejtën për të shtrirë infrastrukturën e nevojshme të komunikimeve elektronike ose kostot e realizimit të së drejtës së tillë janë të larta në mënyrë jo-proporcionale, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (tutje referuar si - ART) mund të kërkojë që ndonjë operator ose nga personat tjerë që kontrollojnë infrastrukturën përkatëse që të lejojnë, në kushte jo-diskriminuese shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës ekzistuese

relevante, ose shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike kur kjo kosto është efikase dhe nuk kërkon punë të konsiderueshme shtesë. Në këtë rast, ART do të konsultojë personat e interesuar, në përputhje me procedurat, afatet dhe kushtet e përcaktuara në paragrafin 8 të këtij Neni.

- (3) Procedura dhe kushtet për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës do të përcaktohen në Marrëveshje ose me procedurat dhe kushtet e përshkruara sipas akteve ligjore;
- (4) Pronari i infrastrukturës nuk mund të refuzoj lidhjen e Marrëveshjes me operatorin, ose nëse marrëveshja është lidhur nuk mund të kërkoj ndryshimin ose përfundimin e saj, në rastet e paraqitura në vijim:
 - 4.1) kërkesa arsyetohet, d.m.th operatori nuk është në gjendje ta ushtroj të drejtën e tij për të shtrirë infrastrukturën e nevojshme të komunikimeve elektronike ose në rast se shpenzimet për zbatimin e të drejtës së cekur janë jo-proporcionalisht të larta; kushti do të konsiderohet i pa-plotësueshëm, në rast të disponueshmërisë së mundësive të arsyetuara teknike dhe komerciale për shtrirjen e linjave tjera të reja të komunikimeve elektronike ose shtrirjen/instalimin e pajisjeve dhe aparateve;
 - 4.2) kjo është ekonomikisht e qëndrueshme dhe nuk kërkon asnjë punë thelbësore shtesë; kushti do të konsiderohet i paplotësueshëm në cilëndo nga rastet e cekura;
 - a) në rast se shtrirja e kablllove rezulton me shkeljen e akteve ligjore për shtrirje, mirëmbajtje dhe mbrojtje infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
 - b) kur nuk ka mundësi për të zëvendësuar kabllot e vjetra dhe të papërdorshme në mënyrë që të sigurojnë një hapësirë të mjaftueshme për shtrirjen e kablllove të operatorit, ose në rast se operatori refuzon të zëvendësojë kabllot;
 - c) projektet e shtrirjes të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të miratuara nga pronari i infrastrukturës parashohin shtrirjen e linjës së komunikimeve elektronike ose instalimin e pajisjeve dhe aparateve brenda njëzet e katër (24) muajve dhe pajisjet dhe aparatet, të instaluar dhe linjat e komunikuese elektronike, të parapara nga operatori do të pengonin implementimin e projekteve të tilla;
 - d) kjo do të rezultonte në ndërprerje të papranueshme në funksionimin e aparateve dhe pajisjeve të shtrira/instaluar më parë;
 - e) kjo do të shkelte kushtet teknike për funksionimin e antenave ose shtyllave, të parashikuara në projektin e strukturës.
- (5) Në rast të ekzistimit të kushteve, të specifikuar në paragrafët 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, pronari i infrastrukturës nuk mund ta refuzoj lidhjen e Marrëveshjes me operatorin për shkak të ndonjë arsyeje, si dhe për shkak të detyrimeve për të siguruar funksionimin e rrjetit në rast të situatave emergjente, integritetit të rrjetit dhe sigurisë së të dhënave;
- (6) Refuzimi i pronarit të infrastrukturës që ta lidh Marrëveshjen me operatorin duhet të jetë i bazuar dhe argumentet duhet t'i dorëzohen operatorit, i cili e ka paraqitur kërkesën me shkrim, jo më vonë se brenda afatit kohor prej një (1) muaji që nga data e paraqitjes së kërkesës. Kur kërkesa e operatorit refuzohet, pronari i infrastrukturës duhet që së bashku me përgjigjen negative t'i ofroj operatorit alternativat tjera të bashkë-shfrytëzimit të infrastrukturës së tij/saj aty ku një mundësi e tillë ekziston;
- (7) Në rast të ndonjë konflikti në mes të pronarit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe operatorit në lidhje me të drejtën e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës (arritja e Marrëveshjes), pala e interesuar në ushtrimin e të drejtës ose kushteve të Marrëveshjes (duke

përfshirë çdo kërkesë, që ka të bëjë me Marrëveshjen), mund t'i drejtohet ART-së lidhur me zgjidhjen e konflikteve (duke përfshirë kërkesën për të kërkuar lejimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës) në bazë të nenit 13 të kësaj Rregulloreje;

- (8) ART, sipas procedurës, të përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore, do ta publikoj kërkesën, të ofruar nga pala e interesuar, për të lejuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm i referohemi si Kërkesa) në faqen e saj të internetit jo më vonë se brenda afatit kohor prej një (1) muaji që nga data e marrjes së Kërkesës, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të jenë në gjendje të shprehin mendimin e tyre brenda periudhës kohore, të përcaktuar nga ART, e cila nuk mund të jetë më pak se 28 ditë nga data e publikimit të kërkesës;
- (9) Komisioni për zgjidhjen e konflikteve në bazë të Rregullores për Zgjidhjen e Konflikteve duhet të filloj zgjidhjen e konflikteve jo më herët se pas skadimit të periudhës kohore, e specifikuar në Paragrafin (6) të këtij neni dhe duhet të marrë vendim në lidhje me konfliktin, në bazë të Paragrafit 7 të këtij neni;
- (10) Pronari i infrastrukturës nuk duhet t'i kufizoj të drejtat e operatorit për t'u angazhuar në aktivitetet e komunikimeve elektronike gjatë përdorimit të infrastrukturës së tij/saj;
- (11) Pronari i infrastrukturës, duhet t'i ofroj operatorit qasje elektronike në informatat mbi infrastrukturën e kontrolluar. Në rastet kur një informatë e tillë nuk mund të ofrohet në mënyrë elektronike, pronari i infrastrukturës duhet t'i ofroj operatorit kopjet fizike mbi informatat e kërkuara brenda afatit kohorë prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i pranimit të kërkesës. Pronari i infrastrukturës duhet të siguroj se informata mbi infrastrukturën e kontrolluar është e azhurnuar.

Neni 8

Procedura e arritjes së Marrëveshjes

- (1) Operatori, i cili dëshiron të lidhë Marrëveshjen, duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim edhe dokumentet shtesë, të nevojshme në mënyrë që ta arrijë Marrëveshjen me pronarit e infrastrukturës. Pronari i Infrastrukturës ka të drejtë të kërkojë vetëm ofrimin e dokumenteve shtesë të nevojshme, njëjtë për të gjithë operatoreve, ofrimi i të cilave është i arsyetuar siç duhet;
- (2) Pronari i infrastrukturës do të ketë të drejtën në përcaktimin e një tarife, për investigimin e kërkesës, që korrespondon me koston e ekzaminimit të kërkesës dhe përgatitjes së përgjigjes. ART do të ketë të drejtën të kërkojë arsyeshmërinë e tarifës ose ndryshimin e tarifës nëse ajo nuk korrespondon me shpenzimet e investigimit të kërkesës dhe përgatitjes së përgjigjes.
- (3) Pronari i infrastrukturës, jo më vonë se afati kohor prej një (1) muaji, nga data e parashtrimit të kërkesës, do t'i ofroj një përgjigje me shkrim operatorit, i cili e ka paraqitur kërkesën. Marrëveshja duhet të arrihet jo më vonë se afati kohor prej një (1) muaji nga data e sigurimit të pëlqimit të pronarit të infrastrukturës, ose vendimit të ART-së për të obliguar përdorimin e infrastrukturës. Marrëveshja duhet të përshijë kushtet teknike, komerciale dhe financiare, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve.

Neni 9

Kërkesat e detyrueshme, në lidhje me shfrytëzimin e infrastrukturës

- (1) Operatori, gjatë përdorimit të kësaj infrastrukture, duhet që;

- a) të përdorë infrastrukturën në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes;
 - b) të siguroj që aparatet dhe pajisjet, të shtrira nga operatori nuk shkaktojnë asnjë çrregullim në funksionimin e aparateve dhe pajisjeve të shtrira/instaluara më parë;
 - c) t'i ofroj pronarit të infrastrukturës rregullat për funksionimin e sigurisë dhe specifikimeve të aparateve dhe pajisjeve të shtrira dhe ta informoj pronarin e infrastrukturës për çdo ndryshim në rregullat dhe specifikimet e cekura sipas procedurës, së përcaktuar në Marrëveshje;
 - d) t'i kryejnë punimet në shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike sipas projekteve, të përgatitura, të koordinuara dhe të miratuara sipas procedurës së, të përshkruar nga aktet ligjore;
 - e) të caktoj vetëm personelin e kualifikuar ose kontraktuesin për kryerjen e punëve në shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe të informojë pronarin e infrastrukturës për kontraktuesit sipas procedurës, së përcaktuar në Marrëveshje;
 - f) të jetë (mbahet) përgjegjës për sigurinë në punë gjatë shtrirjes së infrastrukturës së komunikimeve elektronike.
- (2) Me arritjen e Marrëveshjes, operatori duhet, që sipas kushteve teknike, të përcaktuara në Marrëveshjen dhe procedurat, e përcaktuara në nenin 10 të kësaj Rregulloreje, ta përgatis projektin. Periudha kohore për përgatitjen dhe ofrimin e projektit për pronarin e infrastrukturës do të specifikohet në Marrëveshje, megjithatë periudha kohore e cekur nuk mund të marrë më shumë se gjashtë (6) muaj;
- (3) Pronari i infrastrukturës, infrastruktura e të cilit është përdorur nga operatori në përputhje me Marrëveshjen e arritur, do të:
- a) caktoj kushtet teknike dhe të mos pengojë operatorin që të shtrijë kanalet e tjera kabllorë shtesë në vendet, ku kanalet mungojnë ose të vendos kabllorë në rast se nuk ka hapësirë të mjaftueshme në kanalet ekzistuese;
 - b) vendos një procedurë për regjistrimin e gabimeve;
 - c) kryej mbikëqyrjen teknike dhe mirëmbajtje të infrastrukturës;
 - d) informoj operatorin me shkrim për ndonjë riparim të planifikuar të infrastrukturës jo më vonë se një (1) muaj para fillimit të këtyre punimeve, në rast se punët ka të ngjarë të pengojnë aktivitetet e operatorit jo më shumë se për dymbëdhjetë (12) orë dhe në rast se aktivitetet ka të ngjarë të pengojnë për një periudhë më të gjatë kohore - gjashtë (6) muaj para fillimit të punimeve;
 - e) sipas procedurës, të përcaktuar në Marrëveshje, t'i ofroj operatorit kushte për të mirëmbajtur infrastrukturën e vet të komunikimeve elektronike; gjatë ditëve të punës - jo më vonë se brenda afatit kohor prej një (1) ore, gjatë ditëve të pushimit dhe festive si dhe gjatë natës - jo më vonë se tre (3) orë, në rast se nuk ka dispozita tjera në lidhje me këtë që janë parashikuar në Marrëveshje. Koha do të llogaritet prej çastit të regjistrimit të kërkesës së operatorit për të lejuar mirëmbajtjen e infrastrukturës së vet të komunikimeve elektronike;
 - f) në rast të emergjencave, menjëherë të informoj operatorin në lidhje me çështjen, në rast se nuk ka dispozita tjera në lidhje me këtë të cilat janë parashikuar në Marrëveshje.

Neni 10

Përgatitja e Projekteve

- (1) Në rast se nuk është paraparë ndryshe në këtë Marrëveshje, projekti për shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të përgatitet nga operatori;

- (2) Me pranimin e kërkesës nga operatori, pronari i kësaj infrastrukture, brenda afatit kohor prej një (1) muaji duhet të ofroj informacionin të nevojshëm për kryerjen e punimeve projektuese për operatorin dhe/ose projektuesin, të zgjedhur nga operatori dhe të specifikoj kërkesat, me të cilat projekti duhet të përputhet. Kërkesat duhet të jenë mirë të arsyetuara dhe uniforme për të gjithë operatorët dhe të mos jenë të ndryshme nga kërkesat përkatëse, të zbatueshme për njësitë strukturore dhe filialet e pronarit të infrastrukturës ose të ndërmarrjeve, në lidhje me pronarin e infrastrukturës;
- (3) Projekti i përgatitur duhet të koordinohet me pronarin e infrastrukturës;
- (4) Pronari i infrastrukturës duhet të koordinojnë projektin brenda afatit prej një (1) muaji (në rast se nuk është përcaktuar ndryshe në Marrëveshje) që nga data e pranimit të projektit, ose, në rast se projekti nuk arrin të plotësojë kushtet e Marrëveshjes apo kërkesat, e specifikuara më parë nga pronari i infrastrukturës, pronari i infrastrukturës duhet, brenda të njëjtës periudhë kohore prej një (1) muaji në rastet kur nuk është paraparë ndryshe në marrëveshje, t'i ofroj operatorit kërkesa të arsyeshme për të plotësuar apo ndryshuar projektin. Projekti, i pranuar nga pronari e infrastrukturës bëhet pjesë integrale e Marrëveshjes;
- (5) Në rast se aparatet dhe pajisjet, të shtrira sipas projektit, të pranuar nga pronari e infrastrukturës shkaktojnë ndërprerje/çrregullime në funksionimin e aparateve dhe pajisjeve të shtrira më parë, operatori duhet, në bashkëpunim me pronarin e infrastrukturës të përgatisë ndryshimet e projektit dhe të eliminojë arsyet e ndërprerjes/çrregullimit. Marrëveshja duhet të parashikojë kushtet për mbulimin e shpenzimeve për ndryshime të projektit dhe eliminimin e çrregullimeve.

Neni 11

Procedura e përcaktimit dhe pagesës së tarifës për përdorimin e Infrastrukturës

- (1) Operatori duhet të paguaj tarifën për përdorimin e infrastrukturës, të specifikuar në Marrëveshje;
- (2) Pronari i infrastrukturës duhet të caktojë tarifën për përdorimin e infrastrukturës duke marrë parasysh dispozitat relevante të përcaktuara me aktet ligjore. Në rast se palët dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me tarifën për përdorimin e Infrastrukturës, ART, gjatë zgjidhjes së konfliktit, ka të drejtë që të vendos një tarifë të arsyeshme për përdorimin e infrastrukturës, duke marrë në konsideratë:
 - a) të dhënat direkte të kërkuara nga sistemi i kontabilitetit të pronarit të infrastrukturës ose informata tjera të pronarit të Infrastrukturës, të cilat mund të shfaqen gjatë përmbushjes së kërkesave, të përcaktuara me akte nënligjore;
 - b) të dhënat indirekte të kërkuara mbi shpenzimet përkatëse të shërbimeve/produkteve, duke krahasuar çmimet e shërbimeve përkatëse sipas praktikës më të mirë të vendeve tjera, praktikës së shteteve të zhvilluara në mënyrë të ngjashme, praktika e Republikës së Kosovës dhe vlerësimi i raportit në mes të çmimeve me shumicë dhe pakicë të shërbimeve/produkteve përkatëse.
- (3) Detyra e evidentimit të përputhshmërisë së tarifës për përdorimin e infrastrukturës me kërkesat, e ofruar në dokumentin aktual do të kryhet nga pronarit i infrastrukturës;
- (4) Nëse kërkohet nga ART, pronari i infrastrukturës, brenda periudhës kohore, të specifikuar nga ART, do të siguroj një provë substanciale të tarifës për përdorimin e infrastrukturës nga shpenzimet, duke përfshirë kthimin e arsyeshëm në investime;

- (5) Shuma specifike e tarifës për periudhën kontabël do të specifikohet në faturë, dhe i dërgohet operatorit, e cila duhet të paguhet brenda afatit prej një (1) muaji që nga data e marrjes, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në Marrëveshje.
- (6) Në marrëveshje mund të parashihet e drejta e pronarit të infrastrukturës për të rishikuar shumën e tarifës, në rast të ekzistimit të arsyes përkatëse ekonomike, por ndryshimet e tilla mund të bëhen sa më rrallë që e mundshme. Tarifat nuk duhet të ndryshohet në mënyrë drastike dhe të afektojnë (ndikojnë) në vendimin e operatorëve për të braktisur përdorimin e infrastrukturës.
- (7) Në rast se e drejta e cekur është paraparë, pronari i infrastrukturës duhet t'ia paraqesë operatorit ndryshimet e planifikuara të shumës së tarifës dhe bazueshmerinë ekonomike të ndryshimeve të tilla, jo më vonë se tre (3) muaj para data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, në rast se nuk është paraparë ndryshe me Marrëveshje.
- (8) Operatori nuk mund ta refuzoj tarifën, e ndryshuar në këtë rast dhe sipas procedurës dhe kushteve, të parapara në paragrafin (6) të këtij neni, në rast se tarifa e re, e njoftuar me shkrim nga pronari i infrastrukturës është ekonomikisht e arsyetuar, megjithatë në këtë rast operatori fiton të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të marrëveshjes para se të hyjnë në fuqi ndryshimet e tarifës, duke e njoftuar me shkrim për këtë çështje shfrytëzuesin e infrastrukturës.

Neni 12

Kushtet e hyrjes fuqi, ndryshimi dhe përfundimi i marrëveshjes

- (1) Marrëveshja do të hyj në fuqi në datën e nënshkrimit, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në Marrëveshje;
- (2) Secila palë do të ketë të drejtë të iniciojë ndryshimin e kushteve të Marrëveshjes, në rast të ndryshimeve në aktet ligjore, që rregullojnë kushtet e aktiviteteve përkatëse të komunikimeve elektronike;
- (3) Pronari i infrastrukturës do të njoftoj palën tjetër për qëllimin e saj për ta përfunduar Marrëveshjen jo më vonë se dy (2) vite para datës së planifikuar të përfundimit, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në Marrëveshje ose në këtë Rregullore dhe në rast se Marrëveshje është planifikuar të ndërpritet jo për shkak të ndonjë shkelje thelbësore të saj.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- (1) ART do të zgjidh mosmarrëveshjet midis pronarëve të Infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe operatorëve në lidhje me përdorimin e përbashkët të Infrastrukturës mutatis mutandis duke zbatuar dispozitat e Rregullores për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe akteve tjera ligjore.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

- (1) Në rast se pronari i infrastrukturës arrin Marrëveshje me operatorin, edhe pse, sipas nenit 7.4 të kësaj Rregulloreje, pronari i infrastrukturës mund të refuzoj të arrij një Marrëveshje të tillë, marrëdhëniet ndërmjet palëve të një Marrëveshjeje të tillë nuk do të rregullohen nga dispozitat

e nenit 13 të kësaj Rregulloreje me përjashtim të rasteve, kur ekzistojnë shkaqet, të specifikuara në nenet 7.4.1 dhe 7.4.2 të kësaj Rregulloreje që dalin gjatë marrëveshjes, kur lind nevoja për të përfunduar Marrëveshjen për përdorimin e Infrastrukturës, të specifikuara në Marrëveshje.

- (2) Për çështjet që kanë të bëjnë me te drejtën e servitutit do të zbatohet Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore Nr. 03/L-154.
- (3) Personat do të mbajnë përgjegjësi për dështimin në zbatimin e kërkesave, të parashikuara në këtë Rregullore në përputhje me procedurat dhe kushteve, të përcaktuara nga ligjet e aplikueshme.

Neni 15

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

- (1) Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj me një vendim të Bordit të ART-së dhe mbetet në fuqi deri sa të nxirret një rregullore tjetër.

Klasa: 01/12
Nr. Reg. 14

Prishtinë, 19/03/2012

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit të ART
